



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:227944

Datë: 30.08.2022

Numri i dokumentit: 03373263

C.nr.1007/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Besmir Juniku**, në çështjen juridike të paditësit L. D. nga Istogu, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat D. M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kopania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,000.00 Euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **30.08.2022** merr këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditësit- L. D. nga Istogu, në lidhje me këtë çështje juridike **KONSIDEROHET E TËRHEQUR.**

A r s y e t i m

Paditësi L. D. nga Istogu, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat D. M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim dëmi.

Paditësi me parashtresën e datës 26.11.2021 e ka tërhequr padinë ndaj të paditurës së lartcekur, pasi që pala është kompensuar me marrëveshje jashtëgjyqësore, e për këtë çështje nuk ka interes juridik për vazhdimin e procedurës.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke pas parasysh edhe tërheqjen e padisë ka ardhur në përfundim se padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr në kuptim të nenit 261.1 të LPK-së, i cili e përcakton se “261.1 *Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi...*”.

Nga arsyet e cekura më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 261. 1 lidhur me nenin 387.1 pika c) të LPK –së.

Numri i lëndës: 2021:227944
Datë: 30.08.2022
Numri i dokumentit: 03373263

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
C.nr.1007/21, me datë 30.08.2022.**

**Gj y q t a r i
Besmir Juniku**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 261.4 të LPK-së.